

2022

Programi në Kosovë

RAPORTI VJETOR







HISTORIKU

Në vitin 2022, UNICEF-i ka vazhduar me mbështetjen për fëmijët dhe familjet në Kosovë¹, përmes punës për të garantuar respektim të të drejtave të fëmijëve dhe që të gjithë fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë të jenë të shëndetshëm, të mbrojtur dhe të përfshirë në mënyrë që ta arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Me një moshë mesatare prej 26 vjetësh Kosova ka **popullsinë më të re në Evropë**. Ky “dividend demografik” është potencialisht një përshpejtues i fuqishëm i zhvillimit social dhe ekonomik. Megjithatë, qasja në shëndetësi, arsim/edukim e në shërbime tjera sociale cilësore mbetet e kufizuar për shumë fëmijë dhe të rinj, veçanërisht për më të cenueshmit, duke rezultuar në rezultate të dobëta për shumë fëmijë.

Gati 23 për qind e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri dhe 7 për qind jetojnë në varfëri të skajshme. Këta fëmijë dhe familjet e tyre u vunë nën presion edhe më të madh në vitin 2022, kur pësuan nga rritja e inflacionit. Inflacioni u rrit për më shumë se 14 për qind, ku veçanërisht ndikoi në çmimin e bukës dhe të drithërave, mishit, produkteve të qumështit dhe të ushqimit për fëmijë.

Pavarësisht rritjes së fundit të buxhetit për kujdesin parësor shëndetësor, treguesit e shëndetit të fëmijëve në Kosovë mbeten ndër më të këqijtë në rajon. **Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve është katër herë më e lartë se mesatarja e BE-së;** dhe tetë herë më e lartë se mesatarja e BE-së në komunitetet romë, ashkali dhe

¹ Referencat për Kosovën duhet të kuptohen në kontekst të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

egjiptianë, ku shkalla e imunizimit është gjithashtu e ulët dhe qasja në ujë të pastër dhe kanalizim është e kufizuar.

Shumica e fëmijëve në Kosovë ende nuk po mund të kenë fillim të duhur të nxënies, ku **vetëm 15 për qind e fëmijëve të moshës 3-4 vjeçare vijnë në programet e edukimit të hershëm**. Cilësia e arsimit gjithashtu mbetet shqetësim si në nivelin fillor ashtu edhe në atë të mesëm, ku vetëm **41 për qind e fëmijëve të moshës 7-14 vjeç shfaqin aftësi themelore të leximit dhe 42 për qind shfaqin aftësi themelore numerike**. Kjo përqindje është akoma më e ulët në komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë, përkatësisht 18 për qind dhe 13 për qind.

Fëmijët me aftësi të kufizuara vuajnë nga mungesa e identifikimit dhe mbështetjes së hershme nga sistemi shëndetësor dhe edukativ-arsimor, si dhe nga përjashtimi i gjerë nga shkolla: **8 për qind e fëmijëve kanë vështirësi funksionale në të paktën një fushë**, vetëm 3,965 fëmijë me aftësi të kufizuara aktualisht vijnë në arsimin fillor në sistemin arsimor formal.

Rezultatet e ulëta të të nxënies dhe aftësitë e kufizuara vazhdojnë të ndikojnë negativisht në tranzicionin nga shkolla në punë për të rinjtë, ku **në vitin 2022 31.7 për qind e atyre të moshës 15-24 vjeç nuk janë as në punësim, as në arsim e as në trajnim**.

UNICEF-i vazhdoi t'i mbështesë institucionet e Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile në përpjekjet e tyre për t'i adresuar këto sfida të rëndësishme me të cilat u përballen fëmijët gjatë vitit 2022, siç përshkruhet në seksionin vijues.





PROGRAMI I UNICEF-it NË KOSOVË

Në vitin e dytë të zbatimit të Programit të UNICEF-it në Kosovë 2021-2025, puna për arritjen e rezultateve për fëmijët vazhdoi në tri fusha kyçe:

Mbështetja e zhvillimit të fëmijëve të vegjël

(“Dekada e
parë e jetës”)



Promovimi i fuqizimit dhe zhvillimit të aftësive për adoleshentët dhe të rinjtë

(“Dekada e dytë
e jetës”)



Përfshirja sociale dhe monitorimi i të drejtave të fëmijëve për fëmijët më të cenueshëm përgjatë ciklit jetësor.



Gjatë vitit 2022, ofrimi i programit të UNICEF-it arriti në 6.7 milionë dollarë amerikanë, një rritje prej 35 për qind nga viti 2021. Kontributet bujare nga partnerët tanë i kanë mundësuar UNICEF-it në Kosovë të investojë në forcimin afatgjatë të sistemeve për shëndetin, arsimin dhe shërbimet sociale, si dhe t’u ofrojnë adoleshentëve dhe të rinjve aftësi të transferueshme dhe mundësi për punë kuptimplotë dhe angazhim me komunitetet e tyre.



ARRITJET PËR FËMIJËT E VEGJËL

Foshnje të shëndetshme, fëmijë të zhvilluar

Në vitin 2022 UNICEF-i ndihmoi në rritjen e qasjes në shërbimet kritike për gratë shtatzëna dhe fëmijët e vegjël. Programi i mbështetur nga UNICEF-i për vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0-3 vjeç u zgjerua në shtatë komuna të reja, duke e bërë atë një program në mbarë Kosovën një vit më herët se sa ishte planifikuar. **Infermierët kryen 37,355 vizita në vitin 2022, një rritje prej 35 për qind krahasuar me vitin 2021.**

Vizitat në shtëpi gjithashtu i kanë bërë shërbimet shëndetësore për lehona dhe fëmijë më gjithëpërfshirëse dhe më të barabarta, ku një në 10 fëmijë të arritur përmes programit gjatë vitit 2022 ishin nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Me mbështetjen teknike dhe avokimit të UNICEF-it, Ministria e Shëndetësisë ka ndarë 3.2 milionë euro buxhet për ta mbështetur dhe për ta përmirësuar programin e Vizitave në Shtëpi për vitin 2023.

UNICEF-i gjithashtu vazhdoi bashkëpunimin me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike për ta rritur mbulueshmërinë me vaksinim. Një arritje kryesore ishte ripërtrirja e sistemit të zinxhirit të ftohtë të vaksinave në mbarë Kosovën. Për ta adresuar rënien e shkallës së vaksinimit të rregullt gjatë pandemisë, **UNICEF-i gjithashtu mbështeti fushatën e vaksinimit derë më derë, e cila mundësoi identifikimin dhe vaksinimin e 2,203 fëmijëve të pavaksinuar nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.** UNICEF-i vazhdoi t'i mbështesë institucionet e Kosovës në përpjekjet e tyre për ta rritur kërkesën për vaksinim kundër COVID-19. Në këtë drejtim, u ofruan informacione në lidhje me

COVID-19 përmes një fushate derë më derë për mbi dhjetë mijë njerëz që jetojnë në komunitete të cënueshme.

Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara mbeti një fokus kyç për UNICEF-in. Identifikimi i fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje shtesë dhe ofrimi i ndërhyrjes së hershme, në mënyrë ideale sa më shpejt të jetë e mundur pas lindjes, është çelësi i suksesit të tyre në të ardhmen. UNICEF-i finalizoi analizën e situatës mbi ndërhyrjen në fëmijërinë e hershme që identifikoi



pengesat kryesore të nivelit të sistemit për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky studim do të kontribuojë në hartimin dhe financimin e programeve të ndërhyrjes së hershme në të ardhmen.

Investimet në të nxënit e hershëm

Momentumi për investime në edukimin në fëmijërinë e hershme vazhdoi të avancohet në vitin 2022, ku akterë të shumtë prioritzuan zgjerimin e qasjes në shërbime për fëmijët e vegjël si një përsheptues kyç për zhvillimin ekonomik dhe social. **Me mbështetje të UNICEF-it, edukimi në fëmijërinë e hershme është përfshirë si shtyllë kyçe në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës 2022-2026 dhe ligji për edukim në fëmijëri të hershme është dërguar në Kuvendin e Kosovës.** Edhe alokimi buxhetor për edukimin e hershëm për vitin 2023 është rritur për 5.8 milionë euro. UNICEF-i e ndihmoi Ministrinë e Arsimit t'i përcaktojë prioritetet se si dhe ku ta investojë këtë alokim për objektet e reja parashkollore, bazuar në parashikimet e popullsisë dhe praktikat më të mira nga vende të tjera.

UNICEF-i dhe partnerët e tij gjithashtu vazhduan ta ofrojnë edukimin në fëmijërinë e hershme të bazuar në komunitet për më shumë fëmijë në nivel komunal, ku 617 fëmijë frekuentojnë rregullisht 18 qendra dhe 17,674 fëmijë të vegjël janë arritur përmes mbështetjes online dhe në shtëpi.

Edukimi dhe përfshirja e prindërve është thelbësore në vitet e hershme. Angazhimi aktiv i kujdestarit – veçanërisht nga baballarët – u promovua gjatë sesioneve informuese ku morën pjesë 510 persona (40 për qind meshkuj). **Rreth 10,000 njerëz kanë shkarkuar aplikacionin e ri celular “Foleja,” i cili u zhvillua nga UNICEF-i në gjuhën shqipe dhe serbe dhe që përmban informacione kritike për shëndetin, kujdesin, prindërimin dhe edukimin për prindërit e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç.** Suksesi i të nxënit të hershëm varet gjithashtu nga aftësitë dhe kapacitetet e edukatorëve. UNICEF-i ofroi trajnime për edukatorët mbi programet cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të barazisë gjinore për edukimin e hershëm të fëmijëve.



ARRITJET PËR ADOLESHENTËT DHE TË RINJTË

Në vitin 2022, më shumë se 10,600 të rinj u arritën përmes iniciativave të ndryshme për fuqizimin e të rinjve. UNICEF-i në Kosovë përdor partneritete dhe strategji të veçanta për të arritur te të rinjtë nga komunitetet e marginalizuara dhe investon në programim me të rinj me prejardhje të ndryshme për ta ndërtuar kohezionin social.

Transformimi i arsimit online

UNICEF-i shfrytëzoi momentumin nga pandemia për të ndërtuar një mbështetje më të gjerë për një qasje transformuese dhe të strukturuar ndaj mësimdhënies dhe të nxënimit digjital. **Duke parë nevojën për t'i zgjeruar zgjidhjet e të nxënimit digjital për ta përmirësuar cilësinë dhe për ta mbështetur të nxënimit e individualizuar për fëmijët, me mbështetjen e UNICEF-it, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2022-2026 ka përfshirë për herë të parë një shtyllë për transformimin digjital të arsimit parauniversitar.** Kjo strategji ofron një udhërrëfyes për investime rreth gjashtë fushave të të nxënimit digjital: platformat e të nxënimit digjital, përmbajtja, përmirësimi i aftësive të mësimdhënësve dhe mbështetja e tyre, konektiviteti, pajisjet dhe mbështetja institucionale. Për të kontribuar më tej në përmirësimin e infrastrukturës digjitale në shkolla, UNICEF-i shpërndau laptopë për përdorim në shkolla dhe ofroi lidhje të internetit për 39 shkolla në komunat e synuara. Gjithashtu, gjithsej 1,398 mësimdhënës nga komunat e synuara janë trajnuar për teknologjinë digjitale dhe pedagogjinë gjithëpërfshirëse. UNICEF-i gjithashtu vazhdoi ta mbështesë Ministrinë e Arsimit për institucionalizimin e Shkollat.

org, versioni Kosovar i Pasaportës Mësimore, e cila kombinon depozitorin më të madh të video përmbajtjeve mësimore të përshtatur me kurrikulën në Kosovë me mjete komunikimi për t'i angazhuar nxënësit brenda ose jashtë klasës.

Aftësitë e duhura për jetën dhe punën

UNICEF-i forcoi më tej shtrirjen e programeve të tij të zhvillimit të aftësive të të rinjve në arsimin formal. UPSHIFT është një iniciativë novatore sociale e cila mbështet adoleshentët dhe të rinjtë që të bëhen një forcë për ndryshime pozitive sociale, duke ndërtuar aftësi të transferueshme dhe duke krijuar mundësi për t'i informuar anëtarët e komunitetit me ndërhyrje të ndryshme në formën e produkteve ose shërbimeve. PONDER synon t'i përmirësojë aftësitë e të menduarit kritik, me fokus në informacionin dhe mesazhet që adoleshentët dhe të rinjtë marrin nga mediat sociale dhe tradicionale. PODIUM është një punëtori e avokimit social që u mëson të rinjve dhe adoleshentëve se si të avokojnë për të drejtat e komuniteteve të tyre.

Integrimi i këtyre programeve të ngritjes së aftësive të udhëhequra nga të rinjtë në mjedisin shkollor do të thotë se ato do të jenë në dispozicion për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme në Kosovë. Duke u mbështetur në mësimet e nxjerra nga një pilot projekt i vitit 2021, në vitin 2022 UNICEF-i dhe Ministria e Arsimit rishikuan udhëzuesin e zbatimit për këto tri programe të ngritjes së aftësive për ta forcuar më tej zbatimin, monitorimin dhe institucionalizimin. 2,763 adoleshentë (61 përqind vajza) përfituan nga këto programe të ngritjes së aftësive në shkolla.

Kosova Generation Unlimited, një platformë kryesore e partneritetit publiko-privat për aftësitë dhe punësueshmërinë e të rinjve, mori një rritje të madhe në vitin 2022. Ndërsa 220 të rinj - 10 për qind nga komunitetet joshumicë dhe 5 për qind me aftësi të kufizuara, përfunduan praktikën, një model i ri i zbatimit është funksionalizuar nën udhëheqjen e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për t'i rritur dhe bashkëfinancuar praktikat me pagesë, mentorimin dhe trajnimin për 10,000 të rinj gjatë dy viteve të ardhshme.

[Platforma në internet K-GenU](#) është zhvilluar për t'i përputhur të rinjtë që kërkojnë përvojë pune me kompani, OJQ dhe institucione publike. Në fund të vitit 2022 në platformë janë regjistruar 9401 të rinj dhe 532 kompani.

Zgjerimi i mundësive të angazhimit qytetar për të rinjtë ishte një tjetër fokus i rëndësishëm i punës së UNICEF-it në vitin 2022. Qendrat e Inovacionit në pesë komunat e përzgjedhura iu mundësuan 2,486 adoleshentëve dhe të rinjve (58 përqind vajza) të marrin pjesë në programet e zhvillimit të aftësive, dhe si pjesë e nismës Shkenca për Ndryshim, 250 të rinj projektuan dhe zbatuan fushata ndërgjegjësuese në komunitetet e tyre për ta trajtuar çështjen e ndotjes së ajrit. Platforma [Vullnetarët e Kosovës](#) është përmirësuar gjithashtu për ta mbështetur më mirë vullnetarizmin e të rinjve..





ARRITJET NË PËRFSHIRJEN SOCIALE DHE MONITORIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Në vitin 2022, UNICEF-i vazhdoi t'i mbështesë përpjekjet për të trajtuar varfërinë dhe pabarazinë e fëmijëve dhe punoi për t'i forcuar sistemet që mbrojnë fëmijët më të rrezikuar nga dhuna dhe abuzimi. UNICEF-i gjithashtu ka mbështetur institucionet publike për të gjeneruar të dhëna cilësore për fëmijët dhe për ta monitoruar më mirë progresin për të drejtat e fëmijëve në Kosovë.

Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët në rrezik

Në vitin 2022 UNICEF-i mbështeti zhvillimin e pesë Udhëzimeve të reja Administrative për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe krijimin e Ekipeve për të Drejtat e Fëmijëve në 11 komuna. UNICEF-i gjithashtu ka mbështetur trajnimin për 402 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve dhe punëtorë të tjerë të vijës së parë për zbatimin e ligjit në 28 komuna. **Është krijuar një paketë trajnimi për shëndetin mendor për fëmijët për t'i përmirësuar aftësitë e 210 punonjësve të mirëqenies sociale në Kosovë.** Është zhvilluar një platformë mësimore në internet për punën sociale dhe UNICEF-i dhuroi 230 tabletë për t'i ndihmuar punëtorët të kenë qasje në trajnim. UNICEF-i gjithashtu mbështeti zhvillimin e një udhëzuesi për Programin e Strehimit Familjar dhe Birësimin në vitin 2022 për punëtorët socialë që të jenë të vetëdijshëm për ndryshimet në sistem.

Shtatëdhjetë fëmijë të vendosur në përkujdesje familjare përfituan nga shërbimet profesionale psikosociale. UNICEF-i gjithashtu ka mbështetur shërbimet e integruara arsimore dhe psikosociale në Prishtinë për 63 fëmijë që jetojnë në situatë rruge.



Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara

UNICEF-i ndihmoi në krijimin e draftit përfundimtar të Ligjit për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ligji avokon për plane dhe shërbime individuale të bazuara në nevoja që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. UNICEF mbështeti drejtpërdrejt 12 qendra rehabilitimi me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara të drejtuara nga OJQ-të.

Përmirësimi i financimit dhe koordinimit për të drejtat e fëmijëve

Në pesë komunat në fokus, UNICEF-i ndihmoi në zhvillimin e planeve të përbashkëta të punës për ta përmirësuar koordinimin e shërbimeve të ofruara për fëmijët dhe të rinjtë më të marginalizuar dhe në rrezik. Janë mbajtur trajnime për planifikim, monitorim dhe kosto për 170 zyrtarë komunalë. UNICEF-i mbështeti autoritetet e Kosovës që t'i analizojnë implikimet buxhetore për projektligjet dhe të kostojnë shërbimet e reja sociale në mënyrë që komunat të financohen në mënyrë adekuate dhe të qëndrueshme për të mbështetur fëmijët e marginalizuar. UNICEF ka bashkuar forcat me Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve për të avokuar për miratimin e Ligjit

për Financat e Pushtetit Lokal, i cili përfshin një dispozitë për rritjen e fondeve për komunat për të ofruar mbrojtjen e fëmijëve dhe shërbime të tjera sociale.

Të dhëna më të mira për fëmijët

Për herë të parë, Kombet e Bashkuara vlerësojnë shkallën e vdekshmërisë së fëmijëve në Kosovë si pjesë e një përpjekjeje globale. Si rezultat, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka

rritur kapacitetin e saj për të prodhuar vlerësime në kohë të vdekshmërisë së fëmijëve. UNICEF-i bëri një vlerësim të cilësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave administrative në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata në rrezik dhune dhe abuzimi brenda sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe drejtësisë.

Ky vlerësim gjithashtu dha rekomandime për autoritetet përkatëse për të përmirësuar cilësinë dhe nivelet e zbërthimit e të dhënave për fëmijët në nevojë. Vlerësimet e tilla do të ndihmojnë në hapjen e rrugës për fuqizimin e sistemeve të të dhënave administrative në vitet e ardhshme.





MËSIMET E NXJERRA

Zyra e UNICEF-it në Kosovë është e përkushtuar të mësojë nga sukseset dhe sfidat dhe t'i përshtatë programet e saj në përgjigje ndaj kontekstit në zhvillim. Ky seksion fokusohet në mësimet kryesore të nxjerra gjatë vitit të kaluar.

Në vitin 2022, UNICEF-i vuri në dukje se kapaciteti i ulët për t'i menaxhuar fondet për shërbimet sociale në nivel komunal është bërë një pengesë e vazhdueshme nëpër sektorë. Në të njëjtën kohë, ekipi shëndetësor zbuloi se mjeti për përcaktimin e kostos që ata ndihmuan të krijohej për programin e vizitave në shtëpi kishte rezultuar i dobishëm për autoritetet shëndetësore dhe kishte kontribuar në rritjen e fondeve publike për programin. Si rezultat, UNICEF-i i propozoi Ministrisë së Shëndetësisë që ta përdorë të njëjtin mjet për ta mbështetur planifikimin buxhetor. Në vitin 2023 një mbështetje e tillë në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit do të shtrihet në sektorë të tjerë, si arsimi, ku buxhetet në dispozicion për fusha specifike, si edukimi i hershëm ose fëmijët me aftësi të kufizuara, nuk janë kërkuar deri më sot ose mbeten të papërdorura për shkak të kapaciteteve të kufizuara për të planifikuar dhe absorbuar fonde në nivel lokal.

Të dhënat e MICS tregojnë se rreth 8% e fëmijëve në Kosovë kanë vështirësi në të paktën një fushë funksionale. Megjithatë, numri i fëmijëve të identifikuar si me vonesa në zhvillim gjatë viteve të tyre të hershme, veçanërisht mosha 0-3 vjeç, mbeti jashtëzakonisht i ulët në vitin 2022. Ndërhyrja e hershme është thelbësore për t'i mbështetur fëmijët që ta arrijnë potencialin e tyre të plotë, por duket se mbulueshmëria në rritje e shtrirjes shëndetësore parësore përmes vizitave në shtëpi nuk kishte çuar ende në shqyrtimin më të mirë të vonesave në zhvillim.

Për të reaguar ndaj kësaj sfide, UNICEF-i dhe autoritetet shëndetësore kanë rënë dakord të zhvillojnë një mjet të standardizuar të monitorimit të zhvillimit të fëmijëve në vitin 2023, i cili do të integrohet në sistemin e kujdesit parësor shëndetësor.

UNICEF-i gjithashtu punoi për t'i dokumentuar mësimet nga marrja e vaksinave në punën e tij për promovimin e vaksinës kundër COVID-19. Duke u mbështetur në këtë përvojë, UNICEF-i, së bashku me autoritetet shëndetësore, zhvilluan një Plan Veprimi për Komunikimin e Rrezikut dhe Angazhimin e Komunitetit, elementët kyç të të cilit janë përfshirë tani në Planin Kombëtar të Imunizimit. Në këtë mënyrë mësimet e nxjerra nga pandemia do të shfrytëzohen për ta rritur më gjerësisht kërkesën për imunizim, duke përfshirë vaksinat e reja të cilat do t'i shtohen programit rutinë të imunizimit në Kosovë në vitet e ardhshme.

Me evoluimin e pandemisë, UNICEF-i në Kosovë nxori mësimet të rëndësishme për zhvillimin e ekosistemeve digjitale në shkolla. Në vitin 2022 përdorimi i Shkollat.org dhe mjeteve të tjera të edukimit digjital u ul për shkak të kthimit në shkollimin fizik, mungesës së infrastrukturës digjitale në shkolla, aftësive të kufizuara pedagogjike dhe të TIK-ut të mësimdhënësve dhe perceptimit se të nxëniet digjital ishte vetëm një masë “emergjente”. Për një transformim të qëndrueshëm digjital, është thelbësore të punohet ngushtë me autoritetet arsimore në nivele të shumfishta për ta forcuar mjedisin favorizues për të nxëniet digjital dhe të kombinuar duke ndikuar në politika, duke promovuar gjithashtu ndërgjegjësimin dhe duke ofruar përmirësim dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për mësimdhënësit. Promovimi i përfshirjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në proces është thelbësor, veçanërisht duke pasur parasysh angazhimin dhe interesin e tyre të fortë në aftësitë digjitale.

Në sektorin e arsimit, një përfundim i vlerësimit të projektit zbuloi se integrimi i programeve të bazuara në aftësi të UNICEF-it në kurrikulën e shkollës së mesme të lartë ofroi një bazë të mirë për shkallëzimin e programeve dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e këtij lloji të të nxëniet. Megjithatë, vlerësimi rekomandoi përdorimin e pikave shtesë hyrëse, si lëndë specifike të bazuara në aftësi dhe aktivitete jashtëkurrikulare të bazuara në aftësi, për ta

forcuar më tej zgjerimin e programeve kryesore të UNICEF-it për rininë PONDER, UPSHIFT dhe PODIUM në mjedisin shkollor. Ky rekomandim do të zbatohet në vitin 2023 dhe më tej.

Shpallja e Vitit të Personave me Aftësi të Kufizuara nga autoritetet e Kosovës në vitin 2022 ishte një iniciativë e mirëpritur e cila rriti ndërgjegjësimin dhe mirëkuptimin për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, nevojiten burime dhe kapacitete të shtuara për ta përkthyer këtë zotim të rëndësishëm politik në rezultate të qëndrueshme. Prandaj UNICEF-i ofroi mbështetje për ta ndihmuar aktivistin e ri Rijad Mehmeti të krijojë “Team Rijad”, një platformë avokuese e cila bëri bashkë figura të larta politike, persona me ndikim, gazetarë dhe kompani private për t’i mobilizuar të gjithë sektorët e shoqërisë për veprime konkrete drejt përfshirjes së fëmijëve që jetojnë me aftësi të kufizuara. Në vitin e tij të parë, “Team Rijad” bashkëpunoi me 10 biznese private për të instaluar rampa dhe për të ndërtuar tualete të qasshme në shkolla. Ai gjithashtu solli ndërgjegjësim më të madh për nevojën për më shumë asistentë mësimdhënës në shkolla. Kjo nismë e avokimit me shumë aktorë ishte një sukses që UNICEF-i mundi ta ndërtojë në të ardhmen për të siguruar barazi për fëmijët e të gjitha aftësive.





PARTNERITETET

Rezultatet e programit të përshkruara në raport u bënë të mundura falë mbështetjes bujare të partnerëve të mëposhtëm:

		
		
		

UNICEF-i në Kosovë do të dëshironte gjithashtu t'i falënderojë shumë qeveri dhe partnerë të tjerë që kontribuojnë në financimin bazë dhe tematik të UNICEF-it në nivel global, pasi këto burime fleksibël kanë qenë të rëndësishme në arritjen e rezultateve të përshkruara në këtë raport.



unicef  | for every child

mundësi, për çdo fëmijë



UNICEF Kosovo

“Pejton, Ndërtesa Ramiz Sadiku”, C3/2A
Prishtinë/ Kosovë

Ueb-faqja: www.unicef.org/kosovoprogramme

Facebook: UNICEF Kosovo Programme

Instagram: [unicefkosovoprogramme](https://www.instagram.com/unicefkosovoprogramme)

Twitter: [UNICEFKosovo](https://twitter.com/UNICEFKosovo)